

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori IV, 2015

Tiranë, më 07 Mars: Në tremujorin e katërt të vitit 2015, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 99,6 % kundrejt vitit 2010. (Viti 2010 = 100).

Në tremujorin e katërt 2015 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është -2,3 %. Uljen më të lartë e kanë shënuar çmimet e prodhimit në seksionin “Industri nxjerrëse” me 9,5 %. Brenda kësaj industrie vihet re ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 15,3 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimi, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në aktivitetet e Industrisë përpunuese kanë shënuar rritje me 0,3 %. Vihet re rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve kimike me 5,6 %, konfeksionet e veshjeve me 2,7 %, produktet e makinerive dhe pajisjeve me 5,1 %. Ndërsa çmimet e prodhimit të rafinerisë dhe nënprodukteve të naftës kanë shënuar ulje me 3,1 %.

Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2014, çmimet e prodhimit të produkteve vendase shënuan ulje me 2,3 %. Vihet re ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve të seksionit “Industri nxjerrëse” me 12,2 %.

Çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar ulje me 2,2 % krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Në tremujorin e katërt 2015 ndryshimi tremujor i indeksit është -0,4 %. Çmimet e Prodhimit në seksionin “Industri Nxjerrëse” shënuan ulje me 0,8 % krahasuar me tremujorin e tretë 2015. Uljen më të lartë e shënuan çmimet e prodhimit në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 3,2 %.


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të seksionit “Industria përpunuese” nuk ka ndryshuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Pavarësisht se në nivel seksioni indeksi i çmimeve të prodhimit nuk ka ndryshuar, brenda kësaj industrie vihen re rritje dhe ulje të çmimeve të produkteve në aktivitete të veçanta. Çmimet e prodhimit në aktivitetet; “Përpunimi i produkteve ushqimore” kanë shënuar rritje me 0,1 %, në aktivitetin “Metalurgjia” çmimet e prodhimit kanë shënuar rritje 1,5 %. Ndërsa çmimet e prodhimit të produkteve në aktivitetet: “Përpunimi i tekstileve” shënoi ulje me 0,3 % dhe “Prodhimi i produkteve minerale jometalike” shënoi ulje me 0,9 %.

Çmimet e prodhimit në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave” shënuan ulje me 3,4 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Në këtë seksion vlen të përmendet ulja e çmimeve të produkteve në aktivitetin e “Grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve” me 7,5 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase arriti 98,3 % duke shënuar një rritje me 0,1 % krahasuar me tremujorin e tretë 2015. Vlen të përmendet rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionin “Industri Nxjerrëse” me 2,0 %. Çmimet e prodhimit për produktet vendase në seksionin “Industri përpunuese” shënuan ulje me 0,3 %.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit arriti 102,2 % duke shënuar një ulje me 1,0 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Çmimet e prodhimit të produkteve në seksionet: “Industri nxjerrëse” kanë shënuar ulje për 2,6 % ndërsa çmimet e prodhimit të produkteve “Industri përpunuese” kanë shënuar rritje me 0,3 %.

Fig.1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit sipas muajve , Janar 2014 – Dhjetor 2015



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2010=100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	10 - 15	11 - 15	12 - 15	IV - 15
	Gjithsej	100,0	100,1	99,4	99,3	99,6
B	Industri Nxjerrëse	23,9	89,8	87,1	86,8	87,9
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	15,9	87,8	83,8	84,7	85,4
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,4	103,8	103,8	99,2	102,3
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	2,5	102,5	102,5	102,6	102,5
C	Industria Përpunuese	59,9	104,5	104,7	104,7	104,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,5	107,1	107,3	107,2	107,2
11	Prodhimi i pijeve	3,3	107,7	107,6	107,8	107,7
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,2	92,6	92,6	92,6	92,6
13	Përpunimi i tekstileve	0,2	104,7	105,1	105,0	104,9
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,5	107,4	107,3	108,1	107,6
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,1	110,3	110,3	110,3	110,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,2	111,5	111,8	111,8	111,7
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,9	100,8	102,8	102,8	102,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,6	92,7	94,0	93,8	93,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,4	107,6	107,9	107,9	107,8
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,1	102,8	102,8	102,8	102,8
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,3	97,4	97,4	97,4	97,4
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,5	115,7	115,6	115,6	115,6
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	10,7	99,2	98,6	98,8	98,9
24	Metalurgjia	8,7	93,5	94,8	94,8	94,4
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	6,2	107,8	107,6	107,8	107,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	110,8	110,8	110,8	110,8
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,6	110,4	110,4	110,4	110,4
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0,1	115,4	115,4	115,4	115,4
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,3	102,0	102,0	102,0	102,0
31	Prodhimi i mobiljeve	2,1	114,3	113,9	113,4	113,9
32	Industri të tjera p,k,t	0,3	102,7	102,7	102,7	102,7
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	109,4	109,5	109,4	109,4
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	11,6	99,4	99,4	99,4	99,4
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	11,6	99,4	99,4	99,4	99,4
E	Fumizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,6	102,8	102,0	99,1	101,3
36	Fumizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,1	113,0	113,0	113,0	113,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,4	101,5	101,5	101,5	101,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,1	86,7	85,3	79,8	83,9

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

			%	
NVE	Përshkrimi	Peshat	IV-15 / III - 15	VI - 15 / IV - 14
	Gjithsej	100,0	-0,4	-2,3
B	Industri Nxjerrëse	23,9	-0,8	-9,5
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	0,0	0,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	15,9	-3,2	-15,3
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,4	5,6	5,5
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	2,5	1,3	1,1
C	Industria Përpunuese	59,9	0,0	0,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,5	0,1	1,4
11	Prodhimi i pijeve	3,3	-0,4	1,8
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,2	0,0	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,2	-0,3	-1,0
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,5	-0,2	2,7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,1	-0,5	0,6
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,2	-0,1	1,4
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,9	0,2	-1,4
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,6	0,8	-0,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,4	0,0	-3,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,1	-0,3	5,6
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,3	0,0	0,0
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,5	-1,7	-0,6
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	10,7	-0,9	-2,2
24	Metalurgjia	8,7	1,5	-1,3
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	6,2	-0,2	2,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,0	6,2	6,0
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,6	1,1	0,8
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0,1	2,0	5,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,3	0,0	2,0
31	Prodhimi i mobiljeve	2,1	-0,5	2,8
32	Industri të tjera p,k,t	0,3	0,6	-4,4
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	-0,2	-1,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	11,6	0,0	-0,8
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	11,6	0,0	-0,8
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,6	-3,4	-1,9
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,1	0,0	2,1
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,4	0,0	-0,4
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,1	-7,5	-7,2

Tab.3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	10 - 15	11 - 15	12 - 15	IV - 15	IV-15 / IV - 15
	Gjithsej	100,0	97,9	97,7	99,4	98,3	0,1
B	Industri Nxjerrëse	25,3	88,0	86,8	95,9	90,2	2,0
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	13,6	87,5	85,9	99,0	90,8	2,6
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	1,2	112,0	112,0	112,0	112,0	-3,2
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	3,9	102,7	102,7	102,8	102,7	1,4
C	Industria Përpunuese	57,1	103,0	102,9	103,0	103,0	-0,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,8	107,8	108,1	108,0	108,0	0,1
11	Prodhimi i pijeve	5,3	107,4	107,3	107,5	107,4	-0,2
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,3	92,6	92,6	92,6	92,6	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,1	85,4	87,3	86,8	86,5	-1,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	2,3	107,9	108,1	108,1	108,0	1,7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,6	114,6	114,6	114,6	114,6	-3,0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,1	107,2	107,7	107,7	107,5	-0,9
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,4	98,5	98,5	98,5	98,5	0,3
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	2,7	92,7	94,0	93,8	93,5	0,8
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,9	100,7	100,7	100,7	100,7	0,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,0	96,5	96,6	96,6	96,6	0,1
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,6	97,4	97,4	97,4	97,4	0,0
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,8	114,2	114,4	114,4	114,3	-1,4
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	13,6	89,2	88,5	88,7	88,8	-1,2
24	Metallurgjia	2,4	89,4	89,4	89,4	89,4	0,0
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	7,0	100,9	100,7	100,8	100,8	-0,2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,3	110,7	110,7	110,7	110,7	5,5
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,1	108,6	108,6	108,6	108,6	1,6
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0,2	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	2,5	118,4	118,5	118,4	118,4	0,5
32	Industri të tjera p,k,t	0,1	112,1	112,1	112,1	112,1	0,0
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	118,2	118,3	118,2	118,3	0,0
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	19,8	99,4	99,4	99,4	99,4	0,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	19,8	99,4	99,4	99,4	99,4	0,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,4	105,7	105,7	105,7	105,7	0,0
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,6	113,0	113,0	113,0	113,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,6	101,5	101,5	101,5	101,5	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	0,2	79,4	79,4	79,4	79,4	0,0

Tab.4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	10 - 15	11 - 15	12 - 15	IV - 15	IV-15 / III - 15
	Gjithsej	100,0	104,0	102,7	99,9	102,2	-1,0
B	Industri Nxjerrëse	31,3	96,9	92,9	85,9	91,9	-2,6
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	19,3	93,4	87,5	79,7	86,9	-7,1
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	11,4	96,6	96,6	91,7	95,0	7,0
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,6	103,9	103,9	103,9	103,9	0,4
C	Industria Përpunuese	63,9	106,0	106,5	106,7	106,4	0,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	6,1	105,4	105,4	105,4	105,4	0,1
11	Prodhimi i pijeve	0,4	99,2	99,2	99,2	99,2	-3,4
13	Përpunimi i tekstileve	0,5	114,3	114,3	114,3	114,3	-0,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	7,6	107,2	107,0	108,1	107,5	-1,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	8,7	110,9	110,8	110,8	110,8	0,4
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,3	112,2	112,2	112,2	112,2	0,9
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	1,5	102,3	105,2	105,2	104,2	0,1
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	2,1	101,9	102,2	102,2	102,1	0,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,2	113,3	113,3	113,3	113,3	-0,7
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,0	119,9	119,1	119,1	119,3	-2,3
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	6,5	145,1	145,1	145,6	145,2	0,0
24	Metalurgjia	17,9	98,0	99,7	99,7	99,1	1,8
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,1	114,6	114,6	114,9	114,7	-0,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	110,8	110,8	110,8	110,8	6,2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	1,0	110,0	110,0	110,0	110,0	-0,8
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,3	116,5	116,5	116,5	116,5	2,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,4	102,3	102,3	102,3	102,3	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	1,6	104,4	102,6	101,6	102,9	-2,7
32	Industri të tjera p,k,t	0,5	99,9	99,9	99,9	99,9	0,7
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	93,8	93,8	93,8	93,8	-0,3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,8	90,5	88,8	82,7	87,3	-7,9
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	4,8	90,5	88,8	82,7	87,3	-7,9

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industria Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2010 = 100, Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2009Dec}^{2010,M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100),
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1,
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Me qëllim prodhimin e të dhënave në formën e serive kohore afatgjata indekset janë rillogaritur duke aplikuar matricat e konvertuara në nivel mikro (6 – shifror) e cila sjell revizionim të rezultateve të publikuara më parë. Për të patur seri kohore më konsistente dhe më të krahasueshme me seritë kohore me periudhë referuese 2005 = 100, u revizionuan të gjithë të dhenat e publikuara më parë me NVE,Rev,2 dhe 2010 = 100.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky

ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundi.